

STATUTI

SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Marketing Maximus” Sh.p.k

NENI 1

Shoqëria është krijuar dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me normat e akt themelimit, këtij statuti, Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Për sa mësipër ortakët e shoqërisë krijojnë statutin e shoqërisë si mëposhtë vijon:

EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

NENI 2

Emri

Emri i shoqërisë së themeluar do të jetë “**Marketing Maximus**”.

NENI 3

Selia

Selia dhe veprimtaria e e shoqërisë do të jene në adres Selia dhe veprimtaria e e shoqërisë do të jene në adresën Rr. Margarita TUTULANI në katër pasurite pasurite që janë ”me sipërfaqe **71**(shtatëdhjetë e një) **m2**, rregjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës me nr.5/700, në Vol.86 Faqe 68, ZK 8270 dhe me sipërfaqe **86** (tëtetëdhjetë e gjashtë) **m2**, rregjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës me nr.5/695, në Vol.86 Faqe 63, ZK 8270 dhe me sipërfaqe **85** (tëtetëdhjetë e pesë) **m2**, rregjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës me nr.5/47+1-2, në Vol.59 Faqe 36, ZK 8270 dhe me sipërfaqe **57** (pesëdhjetë e shtatë) **m2**, rregjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës me nr.5/47-N61, në Vol.59 Faqe 35, ZK 8270, Kati I, Tirane.

Shoqëria mund të ka të drejtë të ndryshojë seline e saj si dhe të hapë ose mbyllë adresën dytësore si degë të saj.

NENI 4

Objekti

Marrjen e të drejtës së përfaqësimit nga shoqëria që vepron jashtë ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për territorin e Republikës së Shqipërisë. Investimin në fusha të ndryshme si, brokerimi, marketing

online, promovim turizmi, shërbimet në reklama në lidhje me promovimin e shitjeve, eventeve, përgatitjen, prodhimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit dhe faqeve sociale si dhe realizimin e fushatave reklamuese online. Zhvillim e software-ave për web, desktop, mobile etj., duke përfshirë proceset e analizës, dizajnimit si dhe telemarketing në fushën e sigurimit të jetës ose sendeve, energjia, shëndetësia, hotelëria e turizmi në përgjithësi. Objekt i kësaj shoqërie do të jetë çdo lloj aktivitet që nuk bie nënshpreh legjislativ në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 5
Kohëzgjatja

Veprimtaria e shoqërisë është pa afat. Kjo kohëzgjatje mund të ndryshohet nga themeluesi i saj me vendim unanim.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, i cili përbëhet nga kontributi ortakut dhe shoqëria ka 1 (një) kuotë.

Pjesa takuese e ortakut themelues është:

- a) Gezim Cenaj zoteron 100 % (njëqind përqind) të kuotës së kapitalit, që përben një kuotë të shoqërisë.

NENI 7

Kapitali themeltar mund të shtohet ose zvogëlohet vetëm me vendim të ortakut themelues. Shtimi apo zvogëlimi i kapitalit themeltar do të bëhet në varesi të rezultateve ekonomike e në përputhje me normat e legjislativ në fuqi.


NENI 8

Ndryshimet e zotërimit dhe/ose përqindjes së kuotave, që ka ortakut themelues, bëhet sipas legjislativ në fuqi.

NENI 9

Ortakut mund të lëre peng, si barrë siguroese apo si garanci kuotat e zotëruara në këtë shoqëri vetëm pas marrjes së një vendimi unanim nga ana e asamblesë së përgjithshme.

NENI 10
Transferimi kuotave



Kuotat e kapitali themeltar, që ato përfaqësojnë, mund të transferohet me anë të shitjes dhurimit apo çdo mënyre tjetër të njohur nga legjislacioni Shqiptar vetëm me vendim unanim të ortakeve. Bën perjashtim nga ky rregull vetëm kalimi me trashëgimi. Transferimi tek persona të tretë, shqiptar apo të huaj, i pjesëve të kapitalit dhe kuotës që ato përfaqësojnë, bëhet me vendim unanim të ortakeve pas ezaurimit e te drejtes se parablerjes.

NENI 11

Shoqëria mund të kete dhe kontribute të tjera në natyre. Ketu përfshihen të gjitha sendet e paluajtshme në shërbim të shoqërisë si dhe ato të luajtshme, te cilat kalojnë në pronësi të shoqërisë.

FONDET E SHOQERISE

NENI 12

Shoqëria përcakton si fonde elementët e mëposhtëm:

1) Fondi themeltar (qarkullues);

2) Fondi rezervë;

3) Fonde të tjera që mund të jenë të nevojshme gjate veprimtarisë së saj.

Madhësia e secilit fond përcaktohet mbi bazën e vendimit të Asamblesë së ortakëve, i cili merr vendim gjithashtu edhe për qelimin e përdorimit të tij.

DREJTIMI ADMINISTRATIV.

NENI 13

Shoqëria ka si organe të saj:

a) Asamble e ortakëve

dhe

b) Administratorin, si përfaqësues ligjor.

Renditja e mësipërme shpreh dhe hierarkinë e organeve drejtuese të shoqërisë.


NENI 14

Administratori i shoqërisë do jete Gezim Cenaj.

E gjithë veprimtaria e shoqërisë administrohet nga administratorët në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 15

Administratori i shoqërisë ka në kompetencë të emergjente, si përfaqësues i tyre, vetëm punonjësit të shoqërisë për realizimin e detyrave të rëndësishme në interes të shoqërisë. Kompetencat e personave të autorizuar përcaktohen në aktin e autorizimit të posaçëm. Për veprimtari të thjeshta si aplikime për vertetime pranë



organeve shtetërore, aplikime pranë Qendrës Kombetare të Biznesit, dorëzime bilancesh, aplikime të ndryshme pranë organeve tatimore mund të kryhen nga persona të tretë, jo punonjes të shoqërisë, të pajisur me autorizim të posaçëm.

NENI 16

Shoqëria nuk merr përsiper veprimet e pasojat që vijnë prej tyre, të kryera nga të autorizuarit në tejkalim të kompetencave të percaktuara në autorizim.

Ky rregull vlen dhe për Administratorin që tejkalon kompetencat që i janë dhënë nga ligji e nga ky statut.

NENI 17

Veprimtaria e shoqërisë, administrohet nga administratori në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 18

Administratori për shqyrtimin e bilancit vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe menyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabel, emeron një ose disa eksperte kontabel.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

NENI 19

Të drejtat dhe detyrimet

Asambleja është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Vendimet e Asamblesë merren vetëm me unanimitet votash.

Asambleja ka si kompetencë:

- a) përcaktin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) miratim e ndryshimeve të statutit,
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- ç) përcaktimin e kompetencave të administratorit në aktin e emerimit,
- d) përcaktimin e shpërblimit të administratorit, likujduesit dhe ekspertëve të fushave të ndryshme.
- dh) mbikqyrjen, zbatimin e politikave tregtare nga administratorët,
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, raporteve të ecurisë së shoqërisë,
- ë) zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit,
- f) shqyrtimin e bilancit vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar,
- g) vendosjen për krijimin e filialeve, degeve ose përfaqësive të shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashketa,
- gj) vendosjen për marrjen e kredive si dhe mbarimin e aktivitetit të shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e shoqërisë vlerësohen me humbje,
- h) realizimin e marrdhënieve të rëndësishme financiare dhe ekonomike të shoqërisë, me persona të tjere fizike ose juridike,

i) emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit teknik të shoqërise, sipas drejtimeve të veprimtarise që do ushtroje shoqëria,

l) riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërise,

ll) emerimin e përfaqësuesve të shoqërise para gjykatës.

NENI 20

Mbledhja asamblesë së ortakëve

Asambleja mblidhet sa here që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqërise, në rastet e percaktuara me ligj, por gjithmonë jo me pak se një here në vit.

Ajo thirret nga administratori ose ortakët e shoqërisë.

Thirrja bëhet me shkresë ose nëpërmjet postes elektronike zyrtare të ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, ditën, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e tu dërgohet ortakëve jo me vonë se shtate dite para dates se parashikuar për mbledhje.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble, vete ose nga një person i autorizuar prej tij me prokurë, ose ortak tjetër.

ADMINISTRATORI

NENI 21

Kompetencat e administratorit

Administratori shoqërise ka për detyrë:

a) të punoje, drejtoje e organizojne në menyre të tille shoqërinë , që të sigurojnë suksesin e saj në veprimtarine ekonomiko-financiare që ajo kryen,

b) të ndjekin politikën tregtare të vendosur nga asambleja e ortakëve,

c) perfaqesojë shoqërinë tregtare në marrëdhëniet me të tretët,

ç) të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave administrative, shkresave e dokumentave privatë të shoqërise, e të librave kontabël të shoqërise,

d) të hartojë e nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar; raportin e ecurisë së veprimtarise dhe vazhdimesine e saj, se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve dhe paraqitjen e këtyre dokumentave para asamblese se ortakëve per miratim,

dh) të kryejë regjistrimet dhe dergoje të dhenat e detyrueshme të shoqërise, siç parashikohet ne ligj, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit,

e) të raportojë para asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare,

ë) nënshkruan kontratat e punës me punëmarrësit,

f) ndjek problemet e shoqërise në marrëdhëniet me organet e ndryshme shtetërore dhe me personat e tjere fizike e juridike,

g) lidh kontrata me të trete për interesa të shoqërisë, vetem me miratim unanim te asamblese se ortakëve.

gj) përfaqësimin e shoqërise para gjykatës

j) miraton rregulloren e punës.

k) emeron specialist te fushave te ndryshme si drejtesia, ekonomia, financat etj. per perfaqesimin e shoqerise perpara gjykatave, organeve administrative, shoqerive te tjera private per realizimin dhe mbrojtjen e interesave te shoqerise.

DREJTIMI TEKNIK I SHOQERISE

NENI 22

Per veprimtari ne fusha te veçanta (ne te cilat ligji percakton drejtim nga specialistet te licensuar), shoqeria do te punesojeme kontrata pune specialist te licensuar sipas fushes perkatese.

MARRDHËNIET FINANCIARE

NENI 23

Shoqeria ka të drejte të hape llogari rrjedhëse, kursimi e depozite prane bankave te vendit ose te huaja në shteterore ose private dhe të kryeje veprimet e likuidimit të furnitorëve të saj e të paguhet, për shërbimet që ofron, nëpermjet tyre. Per sigurimin e veprimtarise ka te drejte të financohete në leke ose valute te huaj.

NENI 24

Shoqëria pergjigjet për kontributet fiskale, sigurimet shoqërore dhe afatet e derdhjes së tyre. Personat e ngarkuar me kete detyre duhet te mbajne dokumentacin te rregullt financiar.

Ne fund te vitit financiar, Administratori duhet te dorezoje pranë organeve tatimore perkates bilancin e të ardhurave per efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron ne muajin dhjetor te çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionin ne fuqi.


MARRDHENIET E PUNESIMIT

NENI 25

Administratori vendos për personat qe do punësohen në aktivitetin e shoqerise. Punësimi do bëhet në përputhje me aftesite profesionale te punemarresit.

NENI 26

Marrdhëniet e punesimit do regullohen sipas kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve, ne baze të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nenligjore në fuqi. Në kontrate caktohen kushtet e punes, pageses, sigurimit në pune, diteve te pushimit etj.



NENI 27

Ortaku, Administratori dhe personeli i shoqërise është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e shoqërise në përputhje me ligjin.

Çdo punonjës i shoqërise është përgjegjës për kryerjen e detyrës, e përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit.

Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masat disiplinore të parashikuara nga Kodi i Punës.

KONFIDENCIALITETI

NENI 28

Të gjithë personat e punësuar në shoqëri janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e dokumentacionit, të informacionit, të njohurive të fituara si dhe të çdo lloj materiali tjetër konfidencial, me përjashtim të rastit kur këto informacione janë të jashtëligjshme, shkelin normat e moralin e përgjithshëm të shoqërise apo përbëjnë vepra penale.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 29

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve ndaj personave të treta, kalojnë në dispozicion të ortakëve.

NENI 30

Pagesat e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore të personelit behen sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës.

NENI 31


Në rast mbarimi të veprimtarisë së shoqërise, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar përqindjet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojnë në dispozicion të ortakëve sipas masës së kuotave që zoterojnë në shoqëri.

PËRFUNDIMI SHOQËRISE

NENI 32

Shkrirja

Shoqëria mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga ky akt ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, me anë të një vendimi të asamblese së përgjithshme dhe për shkak të falimentimit.



NENI 33
Likujdimi

Në rast përfundimi, shoqëria do të nënshtrohet procedurave të likujdimit.

Për të administruar këte procedure, asambleja e përgjithshme e ortakeve emeron një ose disa likuidatore, të cilet paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin të shoqërisë, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimin.

NENI 33

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nepermjet formave të thithjes ose të bashkimit duke marrë miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

NENI 34

Gjatë fazës së likujdimit, përgjegjësia e administratorëve dhe likuidatorit është e njëjte.

DISPOZITA E FUNDIT

NENI 35


Për sa nuk është shprehur në këtë statut, plotësimi dhe drejtimi i veprimeve bëhet duke iu referuar Ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare dhe Tregtarët" i ndryshuar, si dhe çdo akti tjetër në fuqi të legjislacionit shqiptar.

NENI 36

Ky statut u përpilua nga ortaku themelues i shoqërisë me vullnetin e tij të plote e të lire.

Statuti u hartua në dy kopje të njëjta, në përmbajtje e fuqi ligjore, ku një kopje do të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

ORTAKU SHOQERISE



15/04/2021